Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Student Centre of University of Prishtina / Rruga/Street "Agim Ramadani" p.n.. / 10 000 Prishtina / Kosova

Datë: 11.04.2017
Nr. Prot: 02-212

U.d. I dretjorit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L/189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), të nenit 12 paragrafi 4 te Ligjit për shërbyes civil i Republikës se Kosovës, të nenit 17 dhe shtojcës 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Vendimin nr. 2-589 të datës 10.03.2016 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Vendimin nr. 381/01 dhe nr. 399/10 të datës 06.11.2015 dhe Vendimin nr. 01-470 të datës 16.11.2016 të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Kërkesës nr. 02-212 te dt. 11.04.2017, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), nxjerr:

V E N D I M
Për kompensim për angazhim në procesin e validimit dhe akreditmit

1. Valbone Kadrijaj ka qenë angazhuar për kryerjen e shërbimeve profesionale në pozitën: Ekspert për validim dhe akreditim të institucioneve për arsim dhe aftësim profesional për profilet instalues i ngrohjes qendrore, instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe për profilin saldues.

2. Për punën e kryer e lartpërmendura lidhë Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për 1 ditë pune me pagë prej 100€ (Njëqind euro).

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe në bazë të kërkesës me nr. 02-212 te dt. 11.04.2017, Valbone Kadrijaj i kompensohet pagesa për një ditë pune për arsye se në Marrëveshjen e Shërbimeve të Veçanta me nr. 522/02 të datës 22.11.2016 u janë llogaritur ditët e punës gabimisht kështu që është dëmtuar duke ju llogaritur një ditë punë më pak për të cilën ka qenë e angazhuar e lartcekura.

Vendimi u dërgohet:
1. Valbone Kadrijaj;
2. Divizionit për Buxhet dhe Financa.;
3. Zyrës së Drejtorit/AKK;
5.Arkivit.

Avni Gashi
u.d. i drejtorit të AKK